



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

DETYRË PROJEKTIMI

PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË ZBATIMIT
RIKONSTRUKSION - SHKOLLA “ELEZ ISUF NDREU”
BASHKIA KAMËZ

MIRATOHEM
RAKIP SULI



Hartoi: Ark. Estela Gjyriqi
Ing. Emanuela Meziu
Ing. Aleks Dani

Drejtori i Projekteve dhe Investimeve

Ing. Ramadan Hysa

KAMËZ, 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Kjo Detyrë Projektimi hartohet nga Bashkia Kamëz si Autoritet Kontraktor, me qëllim përcaktimin e kërkesave tekniko-ligjore, funksionale dhe administrative që duhet të respektohen nga projektuesi për hartimin e dokumentacionit të plotë teknik për objektin “Shkolla Elez Isuf Ndreu” – Bashkia Kamëz”.

Objekti parashikohet të jetë në parametrat e duhur për organizmin dhe kryejn e viprimitarisë së mësimdhëbjes duke ofruar shërbime të integruara për komunitetin, në përputhje me standardet bashkëkohore të projektimit, sigurisë, aksesueshmërisë dhe eficiencës energjetike.

Elementi	Të dhënat kryesore
Autoriteti Kontraktor	Bashkia Kamëz
Objekti	Shkolla e ciklit të mesëm “Elez Isuf Nderu”
Sipërfaqe ndërtimi	4,095m ²
Organizimi	3 kate mbi tokë
Gjurme ndërtimi	1,365m ² ,
Popullsia e shërbyer	Rreth 600 nxënës
Tipologjia	Objekt publik arsimor

2. OBJEKTI DHE QËLLIMI I DETYRËS

Objekti i kësaj Detyrë Projektimi është hartimi i dokumentacionit teknik të projektimit në fazat: Analiza e Detyrës së Projektimit, Projekt-Ide Përfundimtare, Projekt Zbatimi dhe Preventiv, për realizimin e rikonstruksionit të shkollës “Elez Isuf Ndreu”.

Qëllimi është që projektuesi të paraqesë një zgjidhje të plotë, të koordinuar dhe të zbatueshme, e cila garanton funksionim të sigurt të objektit, kushte të përshtatshme për nxënësit, ndarje të qartë të flukseve, akses për PAK, efikasitet energjetik dhe mirëmbajtje të arsyeshme gjatë ciklit të jetës së objektit.

3. BAZA LIGJORE DHE TEKNIKE

Projektuesi është i detyruar të hartojë dokumentacionin teknik në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, aktet nënligjore të zbatueshme dhe standardet teknike kombëtare/europiane. Në çdo rast, projektuesi duhet të verifikojë në momentin e projektimit versionin e fundit të akteve ligjore dhe nënligjore të aplikueshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

- Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe rregullat për dokumentacionin teknik të procedurave të prokurimit.
- Ligji nr. 124/2015 “Për eficiencën e energjisë”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore për performancën energjetike të ndërtesave.
- Legjislacioni për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe normat teknike për evakuimin dhe sigurinë e jetës.
- Normat për aksesueshmërinë dhe përshtatjen e mjedisit për personat me aftësi të kufizuara.
- Eurocode EN 1990–EN 1999, përfshirë projektimin sismik sipas S.SH, EN 1998.
- Standardet teknike, higjieno-sanitare dhe funksionale për objektet e kujdesit shëndetësor.

4. FAZAT E PROJEKTIMIT

Projektuesi do të zhvillojë projektin në mënyrë progresive dhe të koordinuar në fazat e mëposhtme. Kalimi nga një fazë në fazën pasardhëse bëhet vetëm pas shqyrtimit dhe miratimit nga Autoriteti Kontraktor.

4.1 Projekti i Zbatimit

Projekti i zbatimit do të përmbajë dokumentacionin e plotë të arkitekturës, konstruksionit, instalimeve elektrike, hidrosanitare, HVAC, mbrojtjes nga zjarri, sistemeve speciale, sistemit të jashtëm, paneleve fotovoltaike dhe çdo disiplinë tjetër të nevojshme për rikonstruksionin e objektit. Dokumentacioni duhet të jetë i koordinuar, pa kundërthënie, me detaje të mjaftueshme për zbatim në terren.

4.2 Preventivi dhe grafiku .

Preventivi do të hartohet mbi bazën e projektit të zbatimit, volumeve të punimeve, analizave të çmimeve, specifikimeve teknike dhe standardeve të tregut. Projektuesi mban përgjegjësi për përputhjen e preventivit me vizatimet, relacionet, detajet dhe specifikimet teknike.

5. PROGRAMI FUNKSIONAL I OBJEKTIT

Projektuesi duhet të respektojë kërkesat e Autoritetit Kontraktor, Detyrën e Projektimi. Projektuesi mund të propozojë riorganizime funksionale vetëm kur ato argumentohen teknikisht dhe sjellin përmirësim të funksionalitetit, sigurisë, aksesueshmërisë, eficiencës së energjisë dhe mirëmbajtjes së objektit, pa cenuar kapacitetet minimale dhe kërkesat funksionale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

Gjatë procesit të hartimit të projektit, Projektuesi, në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor, do të zhvillojë takime koordinuese me drejtuesit e shkollës, me qëllim përcaktimin dhe optimizimin e **planorganizimit të ambienteve të brendshme**, përfshirë zyrat administrative, klasat e mësimdhënjes, laboratorët, ambientet e përbashkëta, sallat e mbledhjeve, bibliotekë, ambientet teknike dhe shërbimet mbështetëse.

Gjithashtu, gjatë hartimit të projektit do të zhvillohen konsultime për **planorganizimin e ambienteve të jashtme**, duke përfshirë sistemin e territorit, hyrjet dhe daljet e objektit, qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve, hapësirat e gjelbëruara, ndriçimin e jashtëm, sinjalistikën, zonat teknike dhe elementët e tjerë të infrastrukturës së jashtme, me qëllim garantimin e një funksionimi sa më efikas, të sigurt dhe në përputhje me standardet për objektet arsimore.

Kati	Funksioni	Ambiente kryesore	Kërkesa specifike
Përdhe	Ambjente me funksione të përziera.	Hyrje, klasa, laboratore, bibliotekë, sallë mbledhje, nyje H/S	Komfort për mësimdhënje, mirorganizim i ambjenteve sipas funksionit.
Kati I	Ambjente me funksione të përziera.	Klasa, laborator, drejtori, ambiente teknike, nyje H/S	Privatësi, mësimdhënje, ambiente pritje, laboratore.
Kati II	Klasa, ambiente teknike.	Klasa, nyje H/S	Komfort për mësimdhënje, mirorganizim i ambjenteve sipas funksionit.

6. KËRKESA ARKITEKTONIKE DHE FUNKSIONALE

- Të garantohet akses universal për PAK, përfshirë rampa, ashensor, korridore dhe tualete të përshtatura.
- Të sigurohet ndarje e qartë e flukseve.
- Të parashikohet sistem i qartë orientimi dhe sinjalistike të brendshme/ të jashtme (wayfinding).
- Materialet e dyshemeve, mureve, tavaneve dhe dyerve duhet të jenë të përshtatshme për objekte arsimore, rezistente ndaj konsumit.
- Të optimizohet ndriçimi natyral, ventilimi dhe komoditeti termik.
- Të parashikohet fleksibilitet për ndryshime të mundshme funksionale në të ardhmen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

7. KËRKESA KONSTRUKTIVE

Meqenëse objekti është ekzistues, projektuesi nuk duhet ta trajtojë strukturën si strukturë të re, por duhet të kryejë vlerësimin teknik të saj.

Projektuesi duhet të hartojë relacionin konstruktiv mbi bazën e gjendjes ekzistuese, dokumentacionit të mundshëm arkivor, rilevimit në terren dhe, kur është e nevojshme, provave apo analizave shtesë.

Nëse nga vlerësimi rezulton se objekti ka nevojë për ndërhyrje, projektuesi duhet të propozojë masa përforcuese të argumentuara teknikisht, si për shembull përforcim të elementeve mbajtëse, riparim të çarjeve, përmirësim të lidhjeve strukturore, ndërhyrje në soleta, trarë, kolona, themele ose elemente të tjera, sipas rastit.

Çdo ndërhyrje konstruktive duhet të jetë në përputhje me Eurokodet, standardet shqiptare SSH/SSH EN dhe legjislacionin shqiptar në fuqi. Projektuesi duhet të shmangë ndërhyrjet e tepërta dhe të propozojë vetëm ato masa që janë të nevojshme për sigurinë, qëndrueshmërinë dhe funksionimin normal të objektit.

8. KËRKESA PËR INSTALIMET MEP

8.1 Instalimet elektrike

Projektuesi duhet të verifikojë gjendjen ekzistuese të rrjetit elektrik, fuqinë e instaluar, panelet elektrike, linjat shpërndarëse, ndriçimin, tokëzimin, mbrojtjen nga rrufeja dhe sigurinë e instalimeve.

- Në projekt duhet të parashikohen vetëm ndërhyrjet e nevojshme për:
 - • rritjen e sigurisë elektrike;
 - • zëvendësimin e linjave të amortizuara;
 - • përmirësimin e ndriçimit të brendshëm dhe të jashtëm;
 - • vendosjen e ndriçimit emergjent;
 - • furnizimin e laboratorëve dhe ambienteve teknike sipas nevojës;
 - • sistemin e tokëzimit dhe mbrojtjes nga mbingarkesat;
 - • rrjetin IT dhe internetin, sipas kërkesave të shkollës.
- Kabinë e re elektrike, gjenerator ose UPS duhet të parashikohen vetëm nëse rezultojnë të domosdoshme nga llogaritjet teknike dhe miratohen nga Autoriteti Kontraktor..



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

8.2 Hidrosanitare

Projektuesi duhet të verifikojë gjendjen ekzistuese të furnizimit me ujë, kanalizimeve, nyjeve sanitare, shkarkimeve të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike.

- Projekti duhet të parashikojë:
- • rikonstruksin ose zëvendësimin e instalimeve të amortizuara;
- • përmirësimin e nyjeve sanitare ekzistuese;
- • krijimin e nyjeve sanitare të përshtatura për PAK, aty ku është teknikisht e mundur;
- • sigurimin e furnizimit të mjaftueshëm me ujë;
- • përmirësimin e shkarkimeve dhe eliminimin e problemeve me lagështirën;
- • kontrollin dhe përmirësimin e largimit të ujërave atmosferike nga çatia, oborri dhe rreth objektit.
- Rezervuarët e ujit ose sistemet shtesë duhet të parashikohen vetëm nëse rezultojnë të nevojshme nga analiza teknike.

8.3 HVAC dhe ventilimi

Projektuesi duhet të vlerësojë sistemin ekzistues të ngrohjes dhe kushtet reale të objektit. Zgjidhja e propozuar për ngrohje, ftohje ose ventilim duhet të jetë ekonomike, e mirëmbajtshme dhe e përshtatshme për një shkollë ekzistuese.

Nuk duhet të përcaktohet paraprakisht një sistem i vetëm, si VRF apo sistem tjetër specifik, pa u bërë më parë analiza teknike dhe ekonomike. Projektuesi duhet të propozojë zgjidhjen më të përshtatshme në varësi të gjendjes së objektit, buxhetit, kapacitetit elektrik, hapësirave teknike dhe kostove të mirëmbajtjes. Ventilimi mekanik duhet të parashikohet vetëm për ambiente ku ventilimi natyral është i pamjaftueshëm, si nyjet sanitare, laboratorët, ambientet teknike ose hapësirat e mbyllura.

9. MBROJTJA NGA ZJARRI, SIGURIA DHE SISTEMET SPECIALE

Projekti i mbrojtjes nga zjarri do të hartohet nga specialistët përkatës dhe do të përfshijë të gjitha masat aktive dhe pasive për parandalimin, sinjalizimin, evakuimin dhe ndërhyrjen në rast zjarri.

- Sistem detektimi dhe alarmi zjarri; hidrante/fikëse sipas normave; rrugë evakuimi dhe ndriçim emergjence.
- Sistem CCTV për ambientet e përbashkëta dhe perimetrin; kontroll aksesi për ambientet teknike, laboratorin, arkivin dhe zonat e kufizuara.
- Rrjet IT, telefoni, Wi-Fi, rack qendror, kabllim të strukturuar dhe mundësi për integrim me sisteme të menaxhimit të objektit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

10. PANELET FOTOVOLTAIKE DHE EFICIENCA ENERGJETIKE

Në çatinë e objektit do të studiohet vendosja e paneleve fotovoltaike me fuqi orientuese 80–100 kWp, me qëllim mbulimin e pjesshëm të konsumit energjetik të objektit. Projektuesi duhet të analizojë orientimin, hijëzimin, kapacitetin mbajtës të strukturës, lidhjen elektrike dhe mirëmbajtjen.

- Të përdoren zgjidhje me konsum të ulët energjie për ndriçimin, HVAC dhe pajisjet teknike.
- Të përgatitet relacion i eficiencës energjetike dhe rekomandime për uljen e kostove operative.
- Të parashikohen materiale fasade me performancë të përshtatshme termike dhe mirëmbajtje të ulët.

11. SISTEMIMI I JASHTËM DHE INFRASTRUKTURA

- Rrugë aksesit për nxënësit dhe stafin.
- Parkim për vizitorë, staf, PAK.
- Trotuare, rampa, gjelbërim, ndriçim i jashtëm, kamera sigurie, gardh perimetral dhe sinjalistikë.
- Lidhje me rrjetet infrastrukturore të zonës: ujësjellës, kanalizime, energji elektrike, internet dhe rrjet zjarrfikës sipas mundësive teknike.

12. DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOJË PROJEKTUESI.

- Në përfundim të secilës fazë të projektimit, Projektuesi do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin përkatës në **5 (pesë) kopje fizike dhe 5 (pësë) kopje elektronike**, në formatet **DWG, PDF, DOCX, XLSX**, si dhe në çdo format tjetër të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor ose të nevojshëm për procedurat e miratimit institucional të vulosor dhe nënshkruar nga stafi projektues.
- Dokumentacioni përfundimtar duhet të përfshijë, por pa u kufizuar në:
 - Projektin arkitektonik të plotë.
 - Relacionin teknik arkitektonik.
 - Projektin konstruktiv të plotë, së bashku me relacionin llogaritës .
 - Projektin dhe relacionin e mbrojtjes nga zjarri (MNZ), së bashku me specifikimet teknike përkatëse.
 - Projektet e instalimeve elektrike (fuqi dhe ndriçim), hidrosanitare, HVAC, IT, rrjete të komunikimit, CCTV, kontroll-akses, sistem alarmi, sistemit të jashtëm, ujërave atmosferike dhe të zeza, si dhe projektin e impiantit fotovoltaik (FV).
 - Specifikimet teknike të përgjithshme dhe të veçanta për të gjitha punimet, materialet dhe pajisjet.
 - Raportin gjeologjik .
 - Raportin sizmik .
 - Raportin e performancës dhe eficiencës energjetike të ndërtesës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

- Preventivin e punimeve.
- Analizat e çmimeve për zërat që nuk mbulohen nga manualët zyrtarë të çmimeve.
- Grafikun e realizimit të punimeve.
- Të gjitha deklaratat, certifikatat, autorizimet dhe dokumentacionin teknik të nevojshëm për aplikimet pranë institucioneve kompetente.
- Çdo dokument tjetër teknik që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, standardet shqiptare ose europiane, apo nga Autoriteti Kontraktor gjatë procesit të projektimit duhet të hartohet nga projektuesi për objektin në fjalë.

Dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë i nënshkruar dhe vëlosur nga projektuesi përgjegjës të çdo disipline, si dhe të jetë i pajisur me të gjitha licencat, deklaratat e përgjegjësisë profesionale dhe dokumentacionin shoqërues, sipas legjislacionit në fuqi. Të gjitha vizatimet duhet të jenë të koordinuara ndërmjet disiplinave dhe të gatshme për zbatim, pa mospërputhje teknike.

13. PËRGJEGJËSITË E PROJEKTUESIT

Projektuesi mban përgjegjësi të plotë profesionale dhe ligjore për saktësinë, koherencën dhe përputhshmërinë e dokumentacionit të hartuar prej tij me detyrën e projektimit, legjislacionin në fuqi, standardet teknike dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

- Të sigurojë koordinimin ndërmjet arkitekturës, strukturës, instalimeve dhe disiplinave të tjera.
- Të shmangë çdo mospërputhje ndërmjet vizatimeve, relacioneve, specifikimeve dhe preventivit.
- Të korrigjojë, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, çdo mangësi që buron nga dokumentacioni i projektimit, sipas parashikimeve kontraktore.
- Të marrë parasysh komentet e Autoritetit Kontraktor në çdo fazë, pa cenuar standardet teknike dhe sigurinë e objektit.

14. KRITERET E MIRATIMIT DHE PRANIMIT

Dokumentacioni teknik do të konsiderohet i pranueshëm vetëm nëse është i plotë, i koordinuar, i zbatueshëm, i argumentuar teknikisht dhe ekonomikisht, si dhe në përputhje me këtë Detyrë Projektimi.

- Miratimi i një faze nuk e çliron projektuesin nga përgjegjësia për saktësinë dhe koordinimin e dokumentacionit në fazat pasuese.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë rishikime, plotësime ose sqarime kur dokumentacioni paraqet paqartësi, mangësi ose mospërputhje.
- Projekti i zbatimit dhe preventivi duhet të jenë të mjaftueshëm për realizimin e punimeve pa nevojë për interpretime thelbësore në terren.

15. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

Kjo Detyrë Projektimi përbën dokumentin bazë teknik dhe kontraktor mbi të cilin Projektuesi do të hartojë të gjithë dokumentacionin teknik të projektit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, normat dhe standardet teknike kombëtare dhe europiane të zbatueshme, si dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Projektuesi është i detyruar të respektojë të gjitha kërkesat funksionale, arkitektonike, urbanistike, konstruktive, teknologjike, mjedisore, energjetike, ekonomike dhe të sigurisë, të përcaktuara në këtë Detyrë Projektimi. Çdo devijim nga kërkesat e saj ose çdo zgjidhje alternative teknike mund të propozohet vetëm nëse argumentohet me relacion teknik të detajuar, vërtetohet se garanton parametra të barasvlershëm ose më të mirë teknike, funksionale dhe ekonomike, si dhe miratohet paraprakisht me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

Projektuesi mban përgjegjësi profesionale për cilësinë, saktësinë, plotësinë dhe koordinimin ndërmjet të gjitha disiplinave të projektimit, duke garantuar që dokumentacioni teknik të jetë i unifikuar, pa mospërputhje ndërmjet projekteve arkitektonike, konstruktive dhe instalimeve inxhinierike, si dhe plotësisht i zbatueshëm gjatë fazës së ndërtimit.

Dokumentacioni teknik duhet të hartohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Eurokodet dhe standardet teknike shqiptare dhe europiane të aplikueshme, si dhe me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë projektimin, ndërtimin, sigurinë strukturore, mbrojtjen nga zjarri, eficiencën e energjisë, mbrojtjen e mjedisit, aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara dhe kërkesat sanitare për objektet e kujdesit shëndetësor.

Afati për hartimin dhe dorëzimin e dokumentacionit të plotë të projektimit është **2 (dy) muaj**, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Projektuesit. Brenda këtij afati Projektuesi duhet të dorëzojë të gjitha fazat e projektimit, dokumentacionin teknik të plotë dhe dokumentet shoqëruese të kërkuara nga kjo Detyrë Projektimi.

Për realizimin e projektit, Projektuesi duhet të angazhojë një staf multidisiplinar të licencuar, minimalisht të përbërë nga:

- Arkitekt (Drejtues Projekti);
- Inxhinier Konstruktor;
- Inxhinier Hidroteknik
- Inxhinier Elektroteknik;
- Inxhinier Elektrik;
- Inxhinier Mekanik
- Inxhinier Mjedisi;
- Ekspert për Mbrojtjen nga Zjarri (MNZ);
- Ekspert për Eficiencën e Energjisë në Ndërtesa;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INVESTIMEVE

- Inxhinier Gjeolog.
- Inxhinier Topograf / Gjeodet;
- Inxhinier Sizmilog/Gjeofizik
- Specialist IT, CCTV, Kontroll-Akses dhe Rrjete Komunikimi;
- Preventivues / Inxhinier Kostosh.

Të gjithë specialistët e angazhuar duhet të jenë të pajisur me licencat profesionale përkatëse dhe të plotësojnë kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi për projektimin e veprave të ndërtimit.

Kjo Detyrë Projektimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Autoriteti Kontraktor dhe është detyruese për Projektuesin gjatë gjithë procesit të hartimit të dokumentacionit teknik, deri në dorëzimin dhe miratimin përfundimtar të projektit.